



Nj o f t i m P u b l i k

Në drejtorinë e Urbanizmit të Komunës së Prishtinës është dorëzuar aplikacioni 05nr.350/02–120296/23 dt.13.06.2023, në emër të aplikuesve: Pronarve, Bahri dhe Shyqyri, Fazliu, Sokol dhe Shefqet Mustafa, Miradije Imeri, Islam Bajrami, Hysen Beka nga Prishtina dhe Investitori "InOn" Sh.p.k, nga Prishtina me certifikatë të biznesit ARBK 810837685 me Drejtor z. Besnik THAQI, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor për ndërtimin e ndërtesës shumë banesore & afariste- **Ndërtesa me 3B+P+15**, në kuadër të Blloku "b_05", Nën Tërësia "B-1", Tërësia hapësinore "B" të Planit Rregullues "Muhaxhirët" në Prishtinë, konkretisht parcelave kadastrale nr.7392-1, 2, 3, 4 & 5; nr.7394-1, 2 & 3, dhe pjesë së parcelës kadastrale nr.7766-0 ZK Prishtinë, sipas projekt propozimit / Planit të situacionit - "zgjidhjes urbane" të prezantuar;

Me aplikacion është prezantuar edhe projekt propozimi për ndërtimin e kompleksit të lartecukur. Bazuar në pikën 2 të nënit 18 të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110 dt. 31.05.2012, "Organi kompetent njofton publikun dhe mundëson komentet për kërkesën e dhënies së lejes së ndërtimit". Komentet lidhur me këtë propozim duhet të dorëzohen nga data **16.11.2023** gjerë me **30.11.2023** në Email adresën: urbanizmprihtine@rks-gov.net.

Kushtet e propozuara: Ndërtesa shumë banesore & afariste – Ndërtesa me 3B+P+15	
a. Destinimi aktual apo i propozuar i shfrytëzimit të tokës:	Tokë bujqësor -"Arë e klasës 1" / Tokë ndërtimore
b. Vija rregulluese	0.0m' Sipas Planit rregullues "Muhaxhiret"
c. Vija ndërtimore	7.0m' Sipas Planit rregullues "Muhaxhiret"
d. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë e parcelës kadastrale përgjatë rrugës publike	7.0m' / 46.00m'
e. Lartësia e lejuar në proporcion me distancën nga kufijtë anësorë dhe të pasmë të parcelës kadastrale.	Anësor - lindore: 7.00m'/40.00m' Pasme- perëndimore : 7.00m'/40.00m' Mrapa- veriore; 22.00m'/43.00m'
f. Përqindja e sipërfaqes ndërtuese në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHP)	Koeficienti 4.0, ose S=12,584m ² , sip. ndërtimore mbi tokë
g. Përqindja e sipërfaqes bruto ndërtuese mbi tokë në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISPN)	40%- ose S=1,180.80m ² e lejuar, S=856.90m ² e propozuar
h. Përqindja e sipërfaqes së gjelbëruar në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHGJ)	40% - ose S=1,180.80m ² i lejuar dhe S=1,230m ² propozuar
i. Përqindja e sipërfaqes së përdorshme nëntokësore në proporcion me sipërfaqen e parcelës kadastrale (ISHN)	70% ose S=2,066.40m ² lejuar dhe S=2,060m ² - propozuar,
j. Numri i hapësirave për vendparkime të automjeteve	132 VP, nëntokë & 18 VP, mbitokë
k. E drejta e ndriçimit natyror për dritaret ekzistuese	Po
l. A ka qasje të pakufizuar në rrugë publike dhe infrastrukturë publike? Po - <input checked="" type="checkbox"/> Jo - <input type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/>	
m. Shfrytëzimi i propozuar a do të gjenerojë ndotje të mjedisit apo zhurmë më të madhe sesa zona përreth? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	
n. A është ndonjë nga punët ndërtimore në zona të mbrojtura, zona të veçanta ose zona të veçanta të mbrojtura? Po - <input type="checkbox"/> Jo - <input checked="" type="checkbox"/> Nuk aplikohet - <input type="checkbox"/> Sqaro:	

Në bazë të Udhëzimit administrativ 06/2017, dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimimi për kategorinë I dhe II të ndërtimeve, neni 13, paragrafët 2 dhe 3, brenda dy ditëve nga pranimi i komenteve, do të vendosen në ueb-faqen e Komunës, si dhe brenda 5 ditëve nga përfundimi i periudhës së komenteve, Komuna do të ofrojë përgjigje me shkrim dhe përgjigje mëherësh do të publikohet në ueb-faqe të Komunës. Në të gjitha komentet tuaja duhet të nënshkruhet numri i kërkesës të shënuar më lartë. Nënshkrimi i Zyrtarit:

